



TERMAT E REFERENCAVE (ToR)

Prokurimi për: **“Zhvillimi i videos për promovimin e aktiviteteve”**

për projektin

“Fuqizimi i Sektorit të Qumështit në Kosovë: Produktiviteti, Cilësia e Qumështit dhe Rezistenca ndaj Ndryshimeve Klimatike (Faza II)”

I. Historiku i Shoqatës

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) është një organizatë lokale jofitimprurëse, e themeluar në vitin 2005 për të përfaqësuar interesat e fermerëve në gjithë Kosovën, me fokus të veçantë te fermerët e blegtorisë dhe të qumështit. Me mbi 19 vite përvojë, SHPQK është një organizatë e njohur dhe e respektuar nga të gjithë akterët publikë dhe privatë të sektorit të bujqësisë në Kosovë, duke e bërë atë një partner të vlefshëm i institucioneve kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare.

Objektivat kryesore të SHPQK-së janë rritja e nivelit të konkurrueshmërisë së fermerëve të qumështit në vend, krijimi i një sektori të zhvilluar të qumështit që i përgjigjet kërkesave të tregut, në përputhje me zhvillimet në tregun evropian, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe me nevojat kryesore që mbështeten nga politikat bujqësore në nivel kombëtar.

Për të arritur këto objektiva, aktivitetet kryesore të SHPQK-së përfshijnë:

- Konsultim të rregullt dhe ofrim të ekspertizës për zgjerimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të fermerëve blegtoralë (veçanërisht aftësive teknike dhe menaxhimit të fermës);
- Ofrim të ekspertizës teknike në zhvillimin/projektimin e politikave bujqësore në nivel kombëtar (veçanërisht skemave të pagesave direkte dhe granteve investuese) si dhe ligjeve dhe standardeve kombëtare që lidhen me nën-sektorin e blegtorisë;
- Ofrim të informacionit të rregullt për anëtarët ekzistues të shoqatës së fermave blegtorale mbi statusin e cilësisë së qumështit dhe masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve higjienike me qëllim rritjen e cilësisë dhe kapacitetit të prodhimit;
- Ofrim të informacionit të përgjithshëm mbi zhvillimet në tregun e nën-sektorit të blegtorisë;
- Avokim dhe përfaqësim të interesave të fermerëve blegtoralë ndaj institucioneve qeveritare dhe palëve të tjera relevante.



Qëllimi i përgjithshëm i këtij angazhimi është zhvillimi i një video promovuese me cilësi të lartë, e cila komunikon në mënyrë efektive fushëveprimin, rëndësinë dhe ndikimin e projektit “Forcimi i Sektorit të Qumështit në Kosovë: Produktiviteti, Cilësia e Qumështit dhe Qëndrueshmëria Klimatike (Faza II)”. Videoja do të theksojë ndërhyrjet kryesore të projektit, duke përfshirë trajnimet me fermerët e qumështit, digjitalizimin e Pikave të Grumbullimit të Qumështit (PGQ), aplikimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme ndaj klimës, si dhe promovimin e lidershit të grave dhe të rinjve brenda zinxhirit të vlerës së qumështit.

Përmes pamjeve, intervistave dhe dokumentimit në terren, videoja do të demonstrojë qartë rezultatet konkrete, përmirësimin e produktivitetit në ferma, rritjen e cilësisë së qumështit dhe forcimin e bashkëpunimit institucional. Për më tepër, videoja do të shërbejë si një mjet strategjik komunikimi dhe avokimi për promovimin e zhvillimit rural gjithëpërfshirës dhe barazisë gjinore në sektorin e qumështit në Kosovë.

Duke paraqitur histori reale të fermerëve-veçanërisht të grave dhe prodhuesve të rinj-videoja do të ilustrojë kontributin e projektit në përfshirjen sociale, qëndrueshmërinë klimatike dhe sigurimin e jetesës së qëndrueshme. Ajo gjithashtu do të rrisë dukshmërinë dhe njohjen publike të SHPQK-së dhe partnerëve të projektit, duke forcuar rolin e tyre në avancimin e një sektori të qumështit konkurrues, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm ndaj klimës në Kosovë.

II. Objektivi i angazhimit

Objektivi është prodhimi i videove promovuese që:

- Thekson ndërhyrjet kryesore të projektit
- Demonstron rezultatet konkrete dhe ndikimin tek fermerët
- Promovon zhvillimin rural gjithëpërfshirës dhe barazinë gjinore
- Rrit dukshmërinë e SHPQK-së dhe partnerëve të projektit

III. Fushëveprimi i punës

Kompania/konsulenti i përzgjedhur do të kryejë këto detyra:

- Organizimin e një takimi fillestar me ekipin e projektit SHPQK
- Rishikimin e dokumentacionit të projektit (LFA, aktivitetet, grupet target)
- Përgatitjen e planit të xhirimeve dhe logjistikës



Zhvillimi i videove

Xhirimet do të realizohen në rajone të ndryshme të Kosovës dhe do të përfshijnë:

- Pamje në ferma (ushqimi klimatikisht i qëndrueshëm, përgatitja e silazhit, menaxhimi i plehut)
- Pikat e Grumbullimit të Qumështit (përdorimi i platformave digjitale, testimi i cilësisë)
- Aktivitetet e grave dhe të rinjve fermerë
- Sesionet e trajnimeve dhe punëtoritë
- Ngjarjet e dialogut të politikave (takime KLDP apo konferenca)
- Përdorimin e dronit, aty ku është e përshtatshme

Produktet

Ofruesi i shërbimit duhet të dorëzojë:

1. Një (1) video kryesore promovuese (8–10 minuta), një për çdo vit (gjithsej 3 video)
2. Një (1) video të shkurtër për rrjete sociale (30–60 sekonda), një për çdo vit (gjithsej 3 video)
3. Materialet burimore të editueshme

Mesazhet kryesore të videos

Videoja duhet të përcjellë qartë:

- Transformimin e sektorit të qumështit në Kosovë
- Rritjen e produktivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së qumështit
- Qëndrueshmërinë klimatike dhe praktikatat e qëndrueshme
- Fuqizimin e grave dhe të rinjve
- Forcimin e organizimit të fermerëve dhe dialogut të politikave
- Kontributin në përafrimin me BE dhe standardet e sigurisë ushqimore

IV. Udhëtimet dhe akomodimi

Të gjitha shpenzimet e transportit dhe kostot tjera mbulohen nga kompania/konsulenti ofertues.

V. Koordinimi dhe raportimi

Koordinimi dhe organizimi do të bëhet nga stafi i SHPQK-së i angazhuar në projekt.

VI. Afati kohor

Prodhimi i videos do të realizohet gjatë periudhës së projektit: **Tetor 2025 – Dhjetor 2028 (3 vite)**



VII. Buxheti dhe kushtet e pagesës

- Pagesa do të bëhet pas miratimit të të gjitha materialeve dhe dorëzimit të videove
Pagesa e parë: në fund të vitit 2026
- Pagesa e dytë do të bëhet pas miratimit të të gjitha materialeve dhe dorëzimit të videove në vitin 2028.

Pagesat realizohen përmes kërkesës me email në: shpqkkamp@gmail.com
milazimmakolli@gmail.com

Gjuha

Videot duhet të jetë në **gjuhën shqipe**.

VIII. Koordinimi dhe raportimi

Kompania/konsulenti do të punojë nën mbikëqyrjen direkte të menaxherit të projektit të SHPQK-së. Stafi i SHPQK-së do të monitorojë nga afër progresin e punës.

IX. Kualifikimet dhe përvoja

Ofruesi i shërbimit duhet të dëshmojë:

- Minimum 2 vite përvojë në prodhim profesional të videove
- Përvojë në projekte zhvillimore ose bujqësore
- Aftësi të forta në storytelling dhe stil dokumentar
- Pajisje profesionale (kamera, zë, dron)
- Përvojë në përmbajtje me titra dygjuhësore
- Portofol me të paktën 3 projekte të ngjashme

Përvoja në zhvillim rural, klimë ose barazi gjinore konsiderohet përparësi.

X. Procedura e aplikimit

Deri më **27 mars**, të gjitha kompanitë/konsulentët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre në adresat: shpqkkamp@gmail.com, info@shpqk.org

Email-i duhet të përfshijë: CV-në, Referencat, Ofertën financiare, Deklaratën mbi marrëdhëniet

Deri më **30 mars**, do të bëhet vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja. Më **31 mars**, kontrata do të nënshkruhet nga të dyja palët.



XI. Vlerësimi i ofertave

Aplikimet e paplota ose ato të pranuar pas afatit të dorëzimit nuk do të merren në konsideratë. Vlerësimi i ofertave do të bazohet në parimin “**vlera më e mirë për para**”, duke përdorur një metodë të pikëzimit të ponderuar për të vlerësuar kombinimin e kualifikimeve të aplikuesve (80%) dhe ofertës financiare (20%).

Kontrata do t’i jepet ofertuesit, oferta e të cilit është vlerësuar si:

- i/e përgjegjshme / në përputhje / e pranueshme, dhe
- ka marrë rezultatin më të lartë të kombinuar nga vlerësimi teknik dhe financiar, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje.
- **Vlerësimi teknik (60%)**

Vlerësimi teknik i ofertave të pranuar do të përbëhet nga:

- Vlerësimi i arsimit (maksimum 30%)
 - Diplomë Bachelor në shkencat bujqësore ose agroekonomike – 20%
 - Diplomë Master në shkencat bujqësore ose agroekonomike – 30%
- Përvoja relevante (maksimum 30%)
 - Minimum 2 vite – 20%
 - 3–5 vite – 30%

Vetëm kompanitë që arrijnë pragun prej **50% të vlerësimit teknik** do të merren në konsideratë për vlerësimin financiar.

- **Vlerësimi financiar (40%)**

Formula:

$$40 \times (\text{Çmimi më i ulët} / \text{Çmimi i propozuar})$$

XII. Deklarata e marrëdhënieve

Aplikanti duhet të përshkruajë nëse organizata/ punonjësit e tij kanë ndonjë marrëdhënie biznesi ose personale me palët e afërta të We Effect, Zyra Rajonale në Shkup, organet drejtues ose punonjësit e saj.

Një palë e afërt (person fizik ose juridik) sipas përkufizimit të We Effect konsiderohet personi që mund të ushtrojë kontroll ose ndikim të rëndësishëm mbi personin tjetër lidhur me vendimmarrjen financiare dhe operative për një aktivitet të caktuar. Qëllimi i Deklaratës është të zbulojë këto informacione, duke e bërë procesin e aplikimit dhe vlerësimit më transparent dhe duke mbështetur ofertat në relevancën e tyre sipas kushteve të tregut të hapur.